

20211853100

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në bazë të nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 16 paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 40/2006, 136/2008, 148/2008, 155/2008, 163/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 98/19, 42/20 dhe 74/21), kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 6 gusht 2021, mori

### V E N D I M

#### **PËR SHPALLJEN E ZGJEDHJEVE PËR ANËTARË TË KËSHILLAVE TË KOMUNAVE DHE KËSHILLIT TË QYTETIT TË SHKUPIT DHE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE DHE KRYETAR TË QYTETIT TË SHKUPIT**

##### I

Shpallen zgjedhje për anëtarë të këshillave të komunave dhe Këshillin e Qytetit të Shkupit dhe për kryetarë të komunave dhe për kryetar të Qytetit të Shkupit.

##### II

Zgjedhjet do të mbahen më 17 tetor 2021.

##### III

Afatet për realizim të veprimeve zgjedhore fillojnë të rrjedhin nga dita e botimit të vendimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

##### IV

Vendimin do ta zbatojnë Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, komisionet komunale të zgjedhjeve, për qytetin e Shkupit Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit dhe këshillat zgjedhorë.

##### V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 09-3732/1  
6 gusht 2021  
Shkup

Kryetari i Kuvendit  
të Republikës së  
Maqedonisë së Veriut  
Mr. **Talat Xhaferi**, d.v.